

ARJAN SHUMELI, LULJETA MINE

**PASURIMI I TERMINOLOGJISË SË AGROMEKANIKËS NGA TABANI
I GJUHËS SHQIPE**

Duke qenë se punimi do të ketë në epiqendrën e vetë *‘fushën e agromekanikës’*, do të ishte me vend dhënia e përkufizimeve të ndryshme, të cilat lidhen me identitetin e termit *‘agromekanikë’*. Termi *‘agromekanikë’* kupton *‘tërësinë e termave që shënojnë koncepte mbi mjetet e automatizuara, të cilat përdoren në fushën e bujqësisë’*. Krahas termit agromekanikë, përdoret edhe termi i barasvlershëm me të *‘mekanizim bujqësor’*. Nga ky këndvështrim, termi *‘mekanizim bujqësor’* lidhet me *‘futjen në zbatim në bujqësi të një sistemi makinash e implantesh të drejtuar nga njeriu, që kryejnë operacione të ndryshme në procesin e rritjes e të zhvillimit të bimëve e të kafshëve, si edhe për marrjen e për ruajtjen fillestare të produkteve bujqësore e blegtorale’*¹. Në *“Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”* (1980) *‘agromekanika’*, si term i fushës, nënkupton *‘diturinë mbi makinat bujqësore’*. Krahas saj, jepet edhe termi sinonimik me të *“mekanikë bujqësore”*. Në gjuhën angleze termat ekuivalentë të njëzuar me ato të gjuhës shqipe janë *‘agro-machinery’*, *‘farm machinery’* dhe *‘agricultural mechanics’*. Agromekanika filloi të ngrihej si fushë mbi bazën e veprimtarisë praktike të shoqërisë, ku konceptet e krijuara filluan të përdorreshin në formën e termave në terminologjinë e fushës përkatëse. Lindja e koncepteve të reja kërkoi terma të rinj për emërtimin e veglave dhe makinerisë bujqësore të sapokrijuar. Një pjesë e këtyre termave, që shënonin vegla, u morën si të tilla nga vetë tabani i shqipes. Lëvrimi tradicional i bujqësisë, me gjerësinë e veprimtarisë së vet, të interesave, të kontakteve me natyrën, i ka dhënë shkas lindjes së një numri të konsiderueshëm termash për kujdesin dhe punimin e tokës, kujdesin dhe përpunimin e produkteve të qumështit etj.

Për hir të studimit në fjalë do të shohim nga afër mënyrën sesi shtresat e leksikut të shqipes kanë kontribuar në pasurimin e leksikut terminologjik të fushës së agromekanikës. Disa kanë kontribuar kaq shumë me terma të rinj, sa që nuk shënohen me emërtesat përkatëse në fjalorët shpjegues të shqipes dhe nuk mund të dallohen si terma që i përkasin kësaj apo asaj shtrese leksikore.

1. **Leksiku popullor:** Sipas J. Thomait, këto fjalë krijohen nga ligjërimi popullor dhe shquhen *‘si fjalë të bukura’*. Mjaft të shpeshta në ligjërimin popullor dhe sinekdoka janë emërtimet e sendeve, sidomos të përdorësve. Kështu nga veshi i kthyer që posedojnë disa përdorse e kanë marrë emrin e tyre shumë almise

¹ Përkufizimi i termave të pjerrët si agro-makinikë, mekanikë bujqësore, mekanizim bujqësor dhe makineri e pajisje bujqësore jepen sipas *“Fjalorit të termave themelore të bujqësisë”*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

si p.sh., **dorje** ‘enë e bakërt me dorezë’, **vegsh**: ‘vorbë’²; **almise**: ‘vegla’; **dhartë**: ‘shkopi me te cilin rrahim misrin kallëz për ta shkoqur’; **dhëmbësi**: ‘rashqel, grabuja’; **falma e qerrit**: ‘quhen të dy drunjtë horizontal që janë anës shtratit të qerres dhe në të cilën ngulen hunjtë vertikal’; **gardhec**: ‘gazhdare e rrumbullaktë e misrit e mbuluar me kashtë’; **gashtë**: ‘gur grihës’; **bolc**: ‘përdheci i parmendës’; **bosti**: ‘shkop i gjatë që përdoret për të shkundur gështenjat’; **ajar** (bised): ‘barazi në peshë, baraspeshë, drejtpeshim; përpjesëtim i barabartë’, vë (bëj) **ajar barrën**; **bigëz** (bigëz kashtë); **biroce** (karrocë); **binoshe** (dru me dy maja); **furkaçe**: S. bigaçe, ngarkaçe etj.

2. Leksiku dialektor. Ka një shtresë fjalësh që përdoren vetëm në dialekte. Dialektizmat, që kanë lidhje me dialektin, kanë një shtrirje më të madhe në gjithë dialektin, ose në shumicën e të folmeve të tij³. Në fushën e agromekanikës janë ngritur në normë dhe janë bërë pronë e terminologjisë në këtë fushë shumë terma që shënojnë vegla bujqësore kryesisht emra *prejfoljorë nga tema prodhuese, sidomos nga pjesorja e dialektit të veriut + ues/ës*: Mes tyre, do të veçojmë disa si p.sh., nga ‘**djeg**’ është formuar termi “**djegës**” pra, ‘një aparat që përdoret në kalldajat tharëse të drithit; **korreë-grirëse**: ‘aparat, i cili kryen dy procese punë njëkohësisht: këput kallirin si makina korreë e thjeshtë dhe grin kashtën si makina kositëse.’ Kujdes duhet treguar me emrat prejfoljorë, të cilat tregojnë vepruesin (*personin*) që kryen veprimin dhe përdorësen (*veglën*). Si rast konkret merret fjala **shkundës** (*person që shkund ullinjtë*) dhe **shkundëse** në togfjalëshin terminologjik ‘*shkundëse kashtë*’.

3. Leksiku krahinor ose krahinorizmat: Këta përdoren më shumë në gjuhën e folur ose në letërsi. Krahinorizmat lidhen me të folmen dhe kanë shtrirje më të kufizuar se dialektizmat në një ose në dy të folme kufitare⁴. Çdo fjalë, që i përket leksikut krahinor, ka sinonimin e vet të barasvlershëm në gjuhën letrare shqipe. Krahinorizmat shënojnë sende, tipare apo dukuri. Në fjalorët shpjegues të shqipes fjalët shënohen me shkurtesat ‘*krahin*’, si p.sh., **bigë** (*krahin*): ‘*mashë; darë prej druri*’. -kap (*marr*) me bigë’; **gaviç** (*krahin*) “*hambar drithi*”, etj.

Leksiku i gurrës popullore (të folmet krahinore) i pasuron njohuritë tona sidomos për disa kategori leksiko-gramatikore. Në mjaft raste, ai plotëson e zgjeron disa vargje leksikore dhe fjalëformuese, duke treguar edhe gjallërinë e tyre në gjuhën e folur të kohës sonë. Sipas A. Kostallarit (1989: 19), këto fjalë janë të integruara në leksikun e ashtuquajtur asnjans, nuk dallohen nga ndonjë ngjyresë e veçantë dialektore dhe shihen si fjalë të shqipes. Në këtë kategori futen disa terma që tregojnë vegla si, **ballzë, blesë; shtrëngojcë; shpojçë**; apo edhe terma të tjerë si **skajore** (*dërrasë anësore, anie*); **shtrungël** (*enë për të mjelë dhentë*); **pallosh** (*shat me vesh të gjatë*); etj. Emërtime vendase, sipas S. Pepës⁵, janë edhe mjaft

² E. Çabej, *Studime etimologjike në fushën të shqipes*, Vëllimi I, f. 59.

³ J. Thomai, *Teksti dhe gjuha*, f. 129, 1992, Tiranë.

⁴ Shih po J. Thomai si më lart.

⁵ S. Pepa, *Të dhëna gjuhësore nga leksiku bujqësor i trevave veriore për lashtësinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar*, në “Leksiku III”, Tiranë, 1989.

Pasurimi i terminologjisë së agromekanikës nga tabani i gjuhës shqipe

vegla dhe përdorëse të tjera si **furatë**: ‘purtekë për të shkundur ullinjtë’; **qeth**: ‘dërrasë rrotullare e lëmuar ku hollojmë’; pjesë të parmandës, si **dorzë**, **thikzë**, **shkopth**, **përdhec**, **hunzë**, **pallë**; pjesë të qerres: **gavell**. Shembuj të tjerë të larmishëm jepen në studimin e J. Kolës⁶ si **birëse**: ‘çekan ose daltë me majë, që përdoret për të hapur vrima’; **doraku**: ‘doreza a vegja e një vegle, e një mjeti ose e një përdorëseje’; **eshkëtores**: ‘qese e vogël për të mbajtur eshkën, gurin e zjarrit dhe urorin’; **shaloku**: ‘vegël si kompas me hapje të këmbëve dy metra që përdoret për të matur tokën për nevojat bujqësore’.

Shumë gjuhëtarë kanë vjelë nga të folme të ndryshme një numër termash që janë tipikë të shumë fushave të veprimtarisë së njeriut. Për nxjerrjen, evidentimin, klasifikimin e tyre nën fushën e agromekanikës u hulumtuan seria e plotë e “Dialektologjisë shqiptare me vëllimet 1, 2 dhe 3”, të cilat, për hir të studimit në fjalë, u krahasuan me fjalorët e shqipes për të parë depërtimin dhe vendin që këto krahinorizma zënë në këta fjalorë.

- Nga krahina e Çamërisë në studimin e **Q. Haxhihasanit**⁷ u volën këta terma të fushës:

gravall (cfurk me 6 dhëmbë); **kalistir** (shat); **këmbëza** (bishti i parmëndës = skopjonë); **kizë** (vegël bujqësie në formën e draprit); **ksistër** (apëza e hostenit); **kuspi** (maja e hekurt e hostenit); **los** (tokmak druri me të cilin thyejmë plisat e dheut); **mehani** (makinë për të shtrydhur ullinjtë); **kopan** (vegël për të shtypur); **mururi** (bishti i kazmës); **sirti** (vigu); **hirollava** (bishti i parmëndës) **spathi** i parmëndës (dallandyska); **kularët**: **kuji** që mban në zgjedha zevlat; **satër** (kandar i vogël që peshon 25 okë); **skurë** (pallëza e hostenit ku zë balte parmenda ja heqim me skulpine); **tërkul** (cfurk); **topore** (sëpatë e vogël); **trikullopate** (cfurk me të cilin hedhim grurin tërshërën) etj. Haxhihasani ka qëmtnuar gjithashtu shumë fjalë të tjera nga veglat dhe përdorëset bujqësore si: **alës** (zinxhir); **buklidhës** (kunj që lidh zgjedhën me sirtin); **carrë** (branë); **darai** (sitë); **çube** (havan gruri); **dorël** (purtekë me të cilin shkundim degët e ullirit); **dubek** qumështi; **dhrimon** (shoshë për të shoshitur grurin); **fërshërë** (purtekë); **govatë** (lopatë me të cilën nxjerrim miellin nga mulliri).

Nga e folura e krahinës së Çamërisë kanë hyrë në ‘Fjalorin e shqipes së sotme’ (1980) termat e mëposhtëm si **këmbëz**, **kizë**, **ksistër**, **kopan**, **sirti**, **kulari**, **satër**, **trikul**. Në anën tjetër, nga krahasimi që u bëhet termave të mësipërm rezultoi se fjalët-terma si **kalistir**, **mehani**, **mururi**, **skurë**, **tërkulë**, **topore**, **trikullopate**, **gavall**, nuk kanë hyrë në ‘Fjalorin e shqipes së sotme’ (1980) edhe pse në rastin e fjalës **gavall**, kanë hyrë fjalë që kanë strukturë fonetike disi të ngjashme si **gavetë**, **gavërz**, **gaviç**, **gavol**, **gavyell** etj.

- Nga krahina e Kavajës në studimin e **M. Çelikut**⁸ u volën këta terma:

⁶ J. Kola, *Prirje të zhvillimit të leksikut të në dritën e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në “Leksiku III”, Tiranë, 1989.

⁷ Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.

Pjesët e qerres:

Aksi (boshti që lidh dy rrotat e qeres); **bucela** (qendra e rrotës ku hyn aksi e ku bashkohen rrezet e rrotës); **harapina** (faqet anësore që ngrihen mbi shtratin); **palla** (mbulesa e metaltë e rrotës); **rreze** (drunj të shkurtër që lidhin qendrën me rrethin e rrotës); **shtrati** (pjesa e qerres mbi të cilin vendosen barra); **ramu** (druri ku mbështet shtrati);

Pjesët e parmendës:

bishtëza; **dorëza** = **doraku**; **doreza**; **gryka**; **hallka**; **krysqe**; **pluri**; **qajka**; **sqapthi**; **veshas**; **vigu**; **kryqi**; vegla të tjera si **cakorre** (sëpatë e vogël); **dume** (matës drithi që merr 10 kg); **kacorre** (sëpatë e vogël); **pallëza** (pjesa metalike e fundit të hostenit); **qyçk** (masë drithi 10 kg); **Rrajsi** * drapër); **takamk** (çekic druri).

Përmes një studimi krahasues të këtyre fjalëve me leksikun e pasqyruar në “Fjalorin e shqipes së sotme” (1980), rezulton se fjalët e mëposhtme *aks*, *bucelë*, *rreze*, *shtrati*, *bishtëza*, *doraku*, *cakorre*, *pallë* gjejnë pasqyrim në këtë fjalor. Një rol të madh në krijimin e këtyre termave në të folurën e Kavajës ka luajtur ngritja e shumë fjalëve të zakonshme në terma si **shtrati i qerres**, **bishtëza**, **dorëza** dhe **doraku i parmendës** etj.

- Nga krahina e Dibrës në studimin e **B. Becit**⁹ u volën këta terma:

Dumruk (çekic i madh prej druri); **kopaçe** (kazmë); **kosha** (kotec për grurin); **teska** (sqepar); **truvel** (turrjel); Nga e folura e krahinës së Dibrës kanë hyrë në “Fjalorin e shqipes së sotme” (1980) termat e mëposhtëm, *kosha* dhe *kopaçe*, kjo e fundit jo me kuptimin e “kazmës”, por me kuptime të tjera.

- Nga krahina e Pukës në studimin e **Xh. Topallit**¹⁰ u volën këta terma

Disht (arka ku bie mielli nga guri kur bluhet); **dumaj** (çekic druri që rrahin zhgunjat); **garravel** (kosh i madh me të cilin mbartin dushkun për shtroje); **grys** (sqepar me ane të kthyera); **kamza e parmendës** (orza); **karrica** (masë drithi 80 okesh); **koshere** (shporte); **kull** (kudhra); **shkam** (pjesa e parmendës që bashkon shtinë me shkëmbin). Në bazë të studimit krahasues rezulton se nga e folura e krahinës së Pukës kanë hyrë në fjalorin e shqipes së sotme” (1980) terma të tillë si *dishtë*, *garravel*, *koshere*, *kull* etj.

- Nga krahina e Hotit në studimin e **Gj. Shkurtaj**¹¹ u volën këta terma:

capan (kazm); **çapër** (anë lëkure që mban qumështin); **garrën** (vegël mjeshtri); **gruolli** (tryel) **kotar** (kandar peshore); **koshar** (kosh i vogël); **kshan** (gërshërë); **llapar** (pjesa e përparme e parmendës); **majung** (vegël druri si makë për të

⁸ M. Çeliku, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Kavajës*, në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.

⁹ B. Beci, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Dibrës*, në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.

¹⁰ Xh. Topalli, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Pukës*, në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.

¹¹ Gj. Shkurtaj, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Hotit*, në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.

Pasurimi i terminologjisë së agromekanikës nga tabani i gjuhës shqipe

imtësuar plisat e dheut); **pluori** (*plug*); **qokaç** (*cekan drurui*); **teiku** (*kular që vlen për të mbërthyer qetë në zgjedhë*); **thumat** (*kunj druri që mbyll grykën e thesit*); **vaga** (*vangë*) –bel).

Nga studimi krahasues me “Fjalorin e shqipes së sotme” (1980) rezulton se nga e folura e krahinës së Hotit kanë hyrë në këtë fjalor termat e mëposhtëm, *koshar, llapar, majung* etj.

4. **Neologjizmat**: Koncepti i “neologjisë” u fut për herë të parë në vitet 1960-të dhe e ka origjinën në gjuhësi (Felber, 1983)¹². Neologjizmat u referohen “krijimit të ri të fjalëve, termave dhe shprehjeve”. Fjalori i gjuhës angleze¹³ i përkufizon neologjizmat si ‘Fjalë ose kuptime të reja për një fjalë të dhënë; dhe 2. Përdorimi ose praktika e krijimit të fjalëve ose kuptimeve të reja për fjalë të dhëna’. Ndërsa Peter Newmark në “Tekstin e Përkthimit”¹⁴ jep këtë përkufizim “Neologjizmat mund të përkufizohen si njësi leksikore të sapo-krijuara që përftojnë një nuancë të re kuptimore”. Dihet që zhvillimi i pareshtur i bujqësisë, ekonomisë, i tregtisë, i transportit, i teknikës dhe i shkencës etj., kërkon në vazhdimësi nga gjuha plotësimin e fjalorit të saj me fjalë, shprehje e terma të rinj, të domosdoshëm për ecurinë e veprimtarisë politike, ekonomike, shoqërore e kulturore të vendit. Për të plotësuar këto kërkesa të këtyre zhvillimeve, në gjuhë lindin të ashtuquajturat **neologjizma**. Lindja e fjalëve të reja (neologjizmave) nxitet edhe nga shkaqe të tjera gjuhësore, si p.sh., nga leksiku dalin jashtë përdorimit e vjetrohen shumë fjalë dhe për t’i zëvendësuar ato duhen krijuar fjalë të tjera. Neologjizmat *nuk hyjnë menjëherë në leksikon e gjuhës standarde*. Më parë ato fitojnë, si të thuash, “praninë” në leksikon e gjuhës shqipe, pastaj me kalimin e kohës, sipas vlerës që kanë, mund të bëhen pronë e standardit. Veç kësaj, duhet theksuar që fjalët e reja (**neologjizmat**) nuk përbëjnë hop a përmbysje në gjuhë, po një zhvillim të natyrshëm e të shkallëshkallshëm, sepse përndryshe brezat njerëzorë s’do të merreshin vesh mes tyre¹⁵. Në fushën e agromekanikës (mekanikës së blegtorisë) fjalë të krijuar kohët e fundit, si, p.sh., “*ajkëto*re: në kuptimin “*vegël e posaçme, që përdoret për t’i marrë ajkën qumështit*”;

5. **Fjalë të vjetra: arkaizma, historizma** etj. Historizmat janë fjalë të vjetruara, që lidhen ngushtë me fatin e sendit a të konceptit që emërtojnë, lidhen edhe me etapa të caktuara historike, ekonomike e kulturore, kurse sot përdoren vetëm për të dhënë me vërtetësi atë periudhë. *Ndërsa arkaizmat janë fjalë që janë vjetruar a po vjetrohen dhe për këtë arsye kanë dalë ose po dalin nga përdorimi, kalojnë nga shtresa aktive në shtresën pasive të leksikut. Arkaizmat kanë dalë nga përdorimi për shkak se kanë dalë fjalë të tjera për të emërtuar po ato realie a dukuri*¹⁶. Në fjalorët e shqipes së sotme historizmat dhe arkaizmat shënohen me

¹² H. Fleber, *Basic principles and methods for the preparation of terminology standards*, in “Standardization of Technical Terminology: principles and Practices”. Heyman, 1983.

¹³ Webster New world College Dictionary (1994-6)

¹⁴ P. Newmark, *Textbook of translation*. Prentice HaH International, 1988.

¹⁵ Neologjizmat tek <http://dualibra.com/?p=776>

¹⁶ Arkaizmat dhe historizmat tek <http://dualibra.com/?p=776>

shkurtesat përkatëse, si, p.sh., **ajar** (hist): taksë në natyrë ku një pjesë e prodhimit ndahej për shtetin, për beun e për kishën'; **aletet** (vjet); **aletet** e farkëtarit. Bëj gati **aletet**; **araba** (vjet): karrocë e hapur, zakonisht me katër rrota, e tërhequr prej kuajsh; **armatura** (hist): Pajisja luftarake e një ushtari në kohët e vjetra e në mesjetë. **armaturë** e lehtë (e rëndë); **bajgore** (vjet): kosh i madh, i lyer jashtë e brenda me bajga dhe me baltë, që përdorej për të mbartur drithë. Një bajgore misër; **çeki** (vjet): Masë peshe e barabartë me 365 dërhëmë, okë e vogël. Bleu një çeki";

6. Një kontribut të madh në pasurimin e terminologjisë së agro-mekanikës ka dhënë edhe **leksiku etnografik**, i cili mblidhet drejtpërdrejt nga goja e popullit ose nga krijimtaria gojore e tij, apo dhe nga veprimtari të përditshme të tij, si marrja e tij në aktivitete të bujqësisë dhe të blegtorisë. Ky leksik përfshin fjalë, të cilat janë karakteristike për jetën dhe jetesën e bartësve të një të folme. Ato janë kryesisht vegla bujqësore. Me këtë rast ja vlen të përmendim fjalët-terma të mbledhura nga e folura e Lushnjës. Duke qenë se *qerrja* përdorej si mjet për transportin e të mbledhurave gjatë stinës së vjeljes, pse jo edhe si mjet transportimi për njerëzit, kjo e folur ka kontribuar shumë me fjalët e veta në pasurimin e kësaj terminologjie.

7. Një tjetër kontribut po kaq të rëndësishëm në formimin e terminologjisë së agromekanikës ka dhënë edhe **leksiku profesional**, i cili përfshin qindra emërtime popullore për vegla bujqësore, mjeshtëri dhe zejтари. Këto fjalë pa dyshim janë një pasuri me vlera të mëdha për terminologjinë e ditëve të sotme. Si të tilla, këtu futen disa kuptime semantike që lidhen me kryerjen e veprimit nga një send a vegël. Nga ky leksik kanë ardhur edhe disa terma të drejtpërdrejtja si: **thandër**: *'thikë që përdoret për të pastruar thundrën e kalit'*; **bishtar**: *'zdrukth për të bërë të rrumbullakosur diçka'*; **rrethore**: *'pjesë metalike që përdoret për të mbajtur me një pykë presën e kosës'*. Leksiku profesional ka luajtur një rol po aq të rëndësishëm në shtimin e kuptimeve semantike të vendosura nga veglat apo mjetet bujqësore, si p.sh., *kazma* me kuptimin *'hap, gërmon'* apo *'gryen'* tokën, por në përdorimin e leksikut profesional flitet për *'shkëmb tokën'* që do të thotë se e *'punoj tokën qilizmë'*, ose *'hap tokë të re me kazmë'*.

Në këtë punim u përpoqëm të vlnim terma të përdorur në krahina të ndryshme të vendit, duke bërë edhe ballafaqime konkrete me depërtimin e tyre në fjalorët shpjegues së shqipes. Duke qenë se leksiku i shqipes është një *"organizëm"* i gjallë që rritet dhe pasurohet vit pas viti, duke marrë parasysh edhe faktorët e ndryshëm historiko-gjuhësorë të këtyre 25 viteve të fundit si dhe lëvizjet e ndryshme demografike, do të ishte e udhës ndërmarrja e një studimi në terren, ku do të mund të evidentoheshin termat e rinj, apo edhe bashkëjetesa e termit të ri me termin e vjetër si dhe rrugët e tjera të pasurimit të leksikut përtej fushës së studimit në fjalë, duke rrokur fusha të tjera të bujqësisë, si vreshtaria, hortikultura, zooteknia.

Pasurimi i terminologjisë së agromekanikës nga tabani i gjuhës shqipe

BIBLIOGRAFI

- B. Beci, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Dibrës*, në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.
- E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Vëllimi I, f. 59.
Fjalori i shqipes së sotme, 1980, Tiranë.
- Gj. Shkurtaç, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Hotit* në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.
- H. Fleber, *Basic principles and methods for the preparation of terminology standards*, in “Standardization of Technical Terminology: principles and Practices”. Heyman, 1983.
- J. Kola, *Prirje të zhvillimit të leksikut të në dritën e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në “Leksiku III”, Tiranë, 1989.
- J. Thomai, *Teksti dhe gjuha*, f. 129, Tiranë, 1992.
- M. Çeliku, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Kavajës*, në Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.
- P. Newmark, *Textbook of translation*. Prentice HaH International, 1988.
- Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.
- S. Pepa, *Të dhëna gjuhësore nga leksiku bujqësor i trevave veriore për lashtësinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar*, në “Leksiku III”, Tiranë, 1989.
- Webster New world College Dictionary (1994-6)
- Xh. Topalli, *Vështrim i Përgjithshëm mbi të folmen e Banorëve të Pukës*, në “Dialektologjia shqiptare”, Vëllimi 3, 1974.

